

**DISA NDRYSHIME NË MARRËVESHJEN PËR SHËRBIMIN E SHPËRNDARJES SË  
ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË  
ENERGJISË ELEKTRIKE (OSHEE) SH.A DHE FURNIZUESIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE**

**(Procedurë e filluar me vendimin nr. 30, datë 09.02.2018 të Bordit të ERE)**

- Në nenin 8 pika 8.1 në fund të paragrafit, në lidhje me “Rregulloren për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, shtohet në fund ***që do të hyjë në fuqi në 1 Janar 2019.***
- Në nenin 8 pika 8.3 propozohet të shtohet : *Në të gjitha rastet e ndërprerjeve të paplanifikuara, me përjashtim të ndërprerjeve të shkaktuara ose rezultatit të ekzistencës së Forcës Madhore, si dhe ato të përkufizuara në Nenin 11, pika 11.1, energjia e cila nominohet nga Furnizuesi por nuk shpërndahet nga OSHEE për shkak të ndërprerjes, do të kompensohet nga OSHEE si më poshtë vijon:*
- Në nenin 11, pika 11.2, paragrafi i fundit, të ndryshohet afati nga 1 ditë në 6 ditë: *OSHEE do të njoftojë Furnizuesin menjëherë pas marrjes dijeni për ngjarjen e ndërprerjes. OSHEE, brenda gjashtë ditë pune, me anë të një akti teknik do të informojë zyrtarisht Furnizuesin në lidhje me rastin e ndërprerjes.*
- Në nenin 12.2 është plotësuar duke u cituar, se cilët do të konsiderohen palët : *Në mënyrë që të lejohet Furnizuesi të marrë masat e përshtatshme, OSHEE, në përputhje me programin vjetor të remonteve, të rakorduara mes Palëve (OSHEE, OST, palë të treta të interesuara), do të informojë me shkrim Furnizuesin jo më vonë se 20 ditë para fillimit të muajit në të cilin parashikohet kryerja e punimeve të mirëmbajtjes, duke specifikuar zgjatjen e punimeve, objektin (vendin) ku do të kryhen këto punime si dhe konsumatorët që parashikohet tu ndërpritet furnizimi.*
- Në nenin 12, pika 12.3, është propozuar ndryshimi i afatit të njoftimit, nga 5 ditë në 1 ditë : *OSHEE, në raste të paparashikuara, me qëllim ruajtjen e sigurisë së rrjetit, ka të drejtë të reduktojë programin e shpërndarjes për një periudhë të caktuar kohore, duke njoftuar Furnizuesin të paktën **1 (një) ditë** pune në avancë si dhe duke provuar që ndërprerja ishte e vetmja mënyrë për të mundësuar sigurinë e rrjetit.*
- Në nenin 12.5 është shtuar: **Është detyrë e furnizuesit të njoftojë konsumatorët me të cilët ka kontratë për ndërprerje të energjisë elektrike, si detyrë funksionale e tij.**
- Në nenin 18.2 paragrafi i fundi është ndryshuar afati i parashikuar për njoftimin nga “një ditë” përpara datës së furnizimit në “jo më pak se tri ditë pune”: *Furnizuesi duhet të njoftojë OSHEE-në se ka lidhur kontratë të furnizimit me një Klient të ri Fundor, jo më pak se tri ditë pune përpara datës së furnizimit.*
- *Aneksi 2.1 propozet të ndryshohet :*

1. Identifikimi i palëve të kontraktuara: \_\_\_\_\_ Sh.P.K dhe KF:

2. Pikat e lëvrimit/tërheqjes:

**DISA NDRYSHIME NË MARRËVESHJEN PËR SHËRBIMIN E SHPËRNDARJES SË ENERGISË ELEKTRIKE NDËRMJET OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGISË ELEKTRIKE (OSHEE) SH.A DHE FURNIZUESIT TË ENERGISË ELEKTRIKE**

**3. Nënstacioni dhe/ose fidri:**

**4. Kodi i pikës së matjes në sistemin e OSHEE;**

**5. Kohëzgjatja e kontratës: (data e fillimit - data e përfundimit):**

**6. Data në të cilën bëhet efektive zgjidhja e kontratës:**

**7. Furnizuesi duhet të paraqesë dokumentacionin teknik si vijon :**

- **Territori gjeografik ku ushtron aktiviten e furnizimit i paraqitur në GIS.**
- **Nënstacioni dhe/ ose fidri ku do të livrohet energjia e siguruar nga furnizuesi e paraqitur në GIS**
- **Skemat elektrike të nënstacioneve/fidrave/kabinave deri në klientin fundor të prezantuar në GIS**
- **Lista e konsumatoreve të ndarë sipas kategorive familjarë, privatë etj.**
- **Kontratën e lidhur me konsumatorin, ku të jetë përfshirë siguria e punës së pajisjeve të konsumatorit përkundrejt sigurisë së punës së Rrjetit elektrik.**